

PROMOVIMI I LIBRIT "KUSURET E ZOTIT SHYTI" NGA AUTORI ARDIAN VEHBIU, NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË NATYRËS DHE SHKENCAVE HUMANE

Në datën 5 Maj 2017, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane të Universitetit “Fan S. Noli” Korçë, u promovua libri “ Kusuret e zotit Shyti”, i autorit **Ardian Vehbiu**. Pedagogu i letërsisë pranë këtij universiteti Dr. Eris Rusi bëri një analizë të detajuar të librit dhe në veçanti të personazhit kryesor. Të ftuar në këtë promovim ishin pedagogë, miq e kolegë të autorit, të cilët e vlerësuan mjaft këtë botim. Autori Ardian Vehbiu prej vitesh jeton në SHBA, por ai është mjaft aktiv në mjediset e komunikimit shqiptar dhe në internet si autor kryesor në blogun “Peisazhe të Fjalës”.

